



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Vendimi Nr.14/24
Datë: 14.02.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 14.02.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me fitimin e kontrollit të pronësisë përmes blerjes së 100% të aksioneve të Studio Moderna Kosovë Sh.p.k., si dhe shoqërive të ndërlidhura si motra në rajon, Studio Moderna Albania, në Shqipëri. Studio Moderna d.o.o. në Malin e zi dhe Studio Moderna DOEL Skopje në Maqedoninë e Veriut nga SMA HOLDING Sh.p.k., shoqëri e grupit e Viva Fresh shpk.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 21.08.2023, me Nr. Prot. 390/23-11/H si dhe plotësimit të kërkesës të datës: 22.12.2022, me Nr. Prot. 656/23-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me fitimin e kontrollit të pronësisë përmes blerës së 100% të aksioneve të Studio Moderna Kosovë SH.P.K), si dhe shoqërive të ndërlidhura si motra në rajon, Studio Moderna Albania, në Shqipëri. Studio Moderna d.o.o., në Malin e zi dhe Studio Moderna DOEL Skopje në Maqedoninë e Veriut nga SMA HOLDING Sh.p.k., shoqëri e grupit e Viva Fresh sh.p.k.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 17.01.2024
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 18.09.2023
4. Më datë 07.12.2023 palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve ndërmjet SMA Holding sh.p.k, në cilësinë e blerësit (blerësi) dhe Studio Moderna Holding Investments B.V në cilësinë e shitësve (shitësit).

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Parashtruesi i kërkesës dhe shitësi kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen për blerjen e aksioneve të lidhur me datë 07 Dhjetor 2023.

SMA HOLDING SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe themeluar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër unik të identifikimit (NUIS): M32315031R si dhe adresë të regjistruar në Rr. "Sami Frashëri" Kulla Metropol, K2, Tiranë, Shqipëri. SMA, ushtron veprimtari të një shoqërie "*holding*", e sapo themeluar për qëllime të këtij transaksioni dhe do zotëroj Shoqërinë Target dhe shoqëritë si motra në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut. SMA Holding është kompani në pronësi të Viva Fresh Sh.p.k. (blerësi).

Viva Fresh Sh.p.k., është kompani vendore e themeluar dhe e regjistruar në Republikën e Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 810670390, me adresë në Magjistrallja Prishtinë Lipjan NN, Suhadol, Graçanicë, Kosovë. Viva Fresh është rrjeti më i madh i shitjes me pakicë në Kosovë, me rreth 3237 punëtor mbi 110 dyqane në 32 qytete të Kosovës. Me qëllim që Viva Fresh të jetë sa më afër familjes, ka ndërtuar 16 pika të konceptit Viva Fresh Family, përbrenda formatit të minimarketeve. Viva Fresh ka një shumëllojshmëri të mbi 280 produkteve të "private label"-it, produkte të dizajnuara **Studio**

Moderna Holding Investments B.V., shoqëri e themeluar në Holandë, sipas ligjeve të Holandës, e regjistruar në Dhomën e Tregtisë të Holandës me numër regjistrimi 69359164 me adresë të regjistruar në Rr. Hoogoorddreef 15, 1101BA, Amsterdam, Holandë (shitësi).

Studio Moderna Kosovë Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Kosovës, me numër unik identifikimi NUI: 810485632, me adresë të regjistruar në Rr. Ukshin Hoti, nr.120, Hy.C3/3B, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës (targeti). Aktiviteti primar i Shoqërisë Target është shitja e produkteve si, dyshekë, jastëkë, mbulesa të shtretërve, jorganë, enë të gatimit dhe produkteve tjera të vogla shtëpiake, të brendeve Top Shop, Dormeo, Delimano Rovus, Walkmaxx dhe Wellneo. Shitja e këtyre produkteve bëhet përmes kanaleve të ndryshme të shitjes, si dyqaneve të shitjes me pakicë, televizionit me reagim të drejtpërdrejtë, faqet e internetit lokale, katalogët, operacionet e qendrës së thirrjeve dhe përmes një rrjeti të gjerë partnerësh me pakicë dhe shumicë, kompania operon mesatarisht përmes dymbëdhjetë (12) dyqane shitjeje dhe hapësira të shitblerjeje. Strategjia kryesore e Studio Moderna Kosova sh.p.k është rritja e të ardhurave duke shitur produkte inovative dhe cilësore të markave **Top Shop, Dormeo, Delimano, Walkmaxx, Wellneo dhe Rovus** në tregun vendor përmes platformës shumë kanalëshe.

Tregu Relevant:

Tregu i Produktit, Tregu përkatës i produkteve janë produkte të konsumit të kategorisë Home (shtëpiake) të cilat kryesisht kanë të bëjnë me pajisjet shtëpiake si produkte të kuzhinës, pajisje elektroshtëpiake të vogla, produkte shtëpiake dhe produkte dekorative.

Tregu gjeografik, do të përcaktohet tregu i Republikës së Kosovës.

Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësim për çështje të konkurrencës në tregun e Republikës së Kosovës, pasi që, mbivendosja e produkteve mes shoqërive të përfshira është e kufizuar. Në aspektin krahasimor gama e produkteve të secilës palëve në përqendrim, rezulton të jetë afërsisht më pak se 5% e produkteve të cilat do të mund të konsiderohen me karakteristika të përbashkëta. Përkatësisht, tregu ku Blerësi operon është i shitjes me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron, ushqimi, pijet, frutat dhe perimet, duhani, etj. Në bazë të dhëna të Blerësi ka më pak se 20% pjesëmarrje në tregun e shitjes me pakicë të produkteve kryesisht ushqimore. Ndërsa, tregu ku Shoqëria Target operon, është ai i produkteve të konsumit të kategorisë shtëpiake, si produkte të kuzhinës, pajisje elektroshtëpiake të vogla, produkte shtëpiake dhe produkte dekorative. Transaksioni nuk krijon tregje të prekura për faktit se shoqëritë e përfshira operojnë kryesisht në sektorë plotësues dhe kombinimi i aktiviteteve nuk do të çojë në një pozicion dominues në treg për asnjë nga linjat e produkteve të përfshira. Në bazë të analizave të tregut, pra tregu për ofrimin e shitjeve me pakicë – supermarkeve në Republikën e Kosovës është treg mjaftë konkurrues pasi ka një numër të madh të kompanive që kanë rrjete të supermaketeve në

tërë Republikën e Kosovës dhe më gjerë. Prandaj sa i përket shkallës së koncentrimit në këtë sektorë mund të themi që është mjaftë i ulët. Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, andaj, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës. Kërkesa për Njoftimin e Përqendrimit është bërë për arsye se Aplikuesi SMA Holding është kompani nën pronësi të Viva Fresh Sh.p.k., kompani vendore e cila ka një shtrirje në tërë Republikën e Kosovës duke ofruar një gamë të gjerë të produkteve për konsumatorët vendorë. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Komisioni ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdaula
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva